

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 59718125

Nr. i fq. / Br. st. -2

Data: / Datum: 19.11.25

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 150/25, 19/11//2025**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 30 tetor 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:50.**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravkoviç (kryesues), Kushtrim Hyseni, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, Gresa Muli, Berat Maloku, Zana Krasniç Saraçi, Aziz Emini, Adem Hoti dhe anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të OSBE-së, UNMIK, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravkoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

***Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:***

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim i hapur për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucione si dhe për të drejtat e komuniteteve;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

***Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.***

2. Diskutim i hapur për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucione si dhe për të drejtat e komuniteteve.

**Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit** – deklaroi se sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare, situata është në nivel të kënaqshëm. Në vitet e kaluara kanë ekzistuar disa pengesa, por fatmirësisht janë eliminuar. Disa qytetarë nga komuniteti serb kanë ardhë në komunë për ta ndryshuar vendbanimin dhe kanë hasur në probleme të përkthimit. Disa njoftime mungojnë në gjuhët zyrtare, por ato duhet të jenë edhe në

gjuhën angleze. Jemi në fund të mandatit tonë dhe kemi pasur diskutime të shumta për këtë temë. Shpresojmë që edhe anëtarët e komitetit të ardhshëm të kenë diskutime për këtë temë, në mënyrë që në praktikë të gjej zbatim përdorimi i gjuhëve zyrtare

3. Të ndryshme.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – shpresoj që komiteti i ardhshëm të punojë më shumë që t'i realizoj kërkesat e tyre. Dua t'ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pasur. Kandidatëve për kryetar të komunës ju dëshiroj suksese në garën e tyre.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:20.**

**Bujar Klinaku**

*Bujar Klinaku*  
**Procesmbajtës**



**Zdravko Zdravković**

*Zdravko Zdravković*  
**Kryesues i K. për Komunitete**